REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA KAVAJE
KESHILLI

Adresa: Shetitorja " Josif Budo " Kavaje Kavaje,me 29.02.2016

# V E N D I M

NR. 09 Date 29.02.2016

**" MBI MIRATIMI N E BUXHETIT TE BASHKISE KAVAJE PER VITIN 2016"**

Ne mbledhjen e tij te dates 29.02.2016, Keshilli bashkiak mori ne shqyrtim Projekt-Buxhetin e vitit 2016 te paraqitur nga Drejtorite perkatese te Bashkise Kavaje.
Në mbështetje të Ligjit nr. 115/2014 "Për ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Shqipëri", Ligjin 139/2015."Per veteqeverisjen vendore", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 14/2015 datë 17.12.2015 "Për Buxhetin e vitit 2016" ,i dekretuar nga Presidenti nr.9376 date 24.12.2015 dhe shkresen nr. 18025 prot. Date 28.12.2015 te Ministrise Financave per transferten e pakushtezuar dhe transferten specifike per cdo funksion transferuar nga pushteti qendror ne ate vendor per vitit 2016 Keshilli Bashkiak

**VENDOSI:**

**1.Te miratoje Buxhetin e vitit 2016 si me poshte vijon:**

**1.1** Plani I te Ardhurave te Bashkise Kavaje per vitin 2016,eshte ne Shumen = 946.950.165 lek

| | |
|---|---|
| Te Ardhura nga Taksat Vendore | = 285.150.000 leke. |
| Te Ardhura nga tarifat vendore | = 113.500.000 leke |
| T e ardhura te tjera | = 16.200.000 leke |
| **SHUMA I** | **414.850.000 LEK** |

Te ardhura te Trasheguara = 82.110.529 lek.

Te Ardhura te pakushtezuara = 317.844.765 lek
Te Ardhura te kushtezuara = 132.144.871 lek

**Shuma II = 532100.165 lek.**

**TOTALI = SHUMA 1 + SHUMA II = 946.950.165. LEK**

**Totali I shpenzimeve te Bashkise Kavaje per vitin 2016 eshte ne Shumen 946.950.165 lek.**

**2.** Miratoi detajimin e buxhetit te Bashkise Kavaje per vitin 2016 si me poshte:
2.1.Miratoi detajimin e buxhetit shpenzimeve te Bashkise Kavaje per vitin 2016 te pasqyruar ne Buxhet pjese perberese e ketij vendimi. Miratoi detajimin e buxhetit te Bashkise Kavaje sipas programeve (shpenzime korente dhe kapitale) te pasqyruara ne Buxhet

Art. 600 = 283.705.256 leke
Art. 601 = 47.397.897 leke
Art. 602 = 326.126.350 leke
Transferta (Keshilli + K.Qarkut) = 9.100.000 leke
F.Rezerve + F.Kontigjences + Emergjenca = 12.000.000 leke
Investime = 268.620.662 leke

**Total i Shpenzimeve Korente + Kapitale = 946.950.165 leke**

2.2.Miratoi planin e shpenzimeve kapitale 268.620.662 leke sipas programeve te prezantuara ne Buxhet pjese e ketij vendimi.

2.3Miratoje rritjen e limitit te te ardhurave te Bashkise Kavaje per vitin 2016, per diferencat e paperdorura ne te ardhura dhe shpenzime te vitit 2015, sipas shumes se percaktuar ne akt-rakordimin perfundimtar me Degen e Thesarit. Ky fond te perdoret per likuidimin e shpenzimeve korente per objektet ne vazhdim, per fatura te palikuiduara nga viti 2015 per arsye te mbylljes se veprimeve financiare .

2.4. Ngarkohet Drejtoria e Burimeve Ekonomike te kryeje avancim te fondeve mujore sipas realizimit te te ardhurave per vitin 2016.

**3**. Per zbtimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria e Burimeve Ekonomike, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria Ligjore dhe sherbimeve mbeshtetese ,Drejtoria e Kontrollit dhe zhvillimit Urbanistik dhe Pronave , Drejtoria e Sherbimeve Publike te Bashkise Kavaje.

**4**. Ky vendim hyn ne fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefektura Tirane.

**SEKRETARE E KESHILLIT BASHKIAK**

**Valbona MUSTAFA**

**KRYETARI I KESHILLIT BASHKIAK**

**Aqif PEZA**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA KAVAJE